



|   |   |   |
|---|---|---|
|  | <p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b><br/>Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b><br/>Opština Priština –Municipality of Prishtina</p> <p style="text-align: right;">01-1835</p> |  |
|---|---|---|

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-240955/22 dt. 02.11.2022, të kërkesit/ pronarëve Sokol Gashani nga Glllogoci, me investitor ”Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën e përkoshme, afariste/depo, e ndërtuar në kuadër të “Planit Zhvillimor Urban” në Prishtinë, në rr. “Aleks Çaçi”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 27.09.2024, lëshon këtë:

## C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

**I. I LEJOHET** kërkesit/ pronarit Sokol Gashani nga Glllogoci, me investitor ”Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-240955/22 dt. 02.11.2022, përdorimi i ndërtesës së përkoshme afariste/depo me etazhitet P+0, e ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore” 05 Nr. 351/02-70138/21 dt. 01.12.2021, të lëshuar nga kjo drejtori, në parcelen kadastrale nr. 10311-1, ZK Prishtinë, në kuadër të Planit Rregullues “Planit Zhvillimor Urban” në Prishtinë.

**II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Aleks Çaçi” ku kanë dalje hyrjet me numrin: 42, në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrimit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

## A r s y e t i m

Kërkesi/ pronari Sokol Gashani nga Glllogoci, me investitor ”Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-240955/22 dt. 02.11.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën e përkoshme, afariste/depo, me etazhitet P+0, e ndërtuar në kuadër të “Planit Zhvillimor Urban” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parces kadastrale nr. 10311-1, ZK Prishtinë, ndërtuar

sipas "Vendimit të Lejes Ndërtimore" 05 Nr. 351/02-70138/21 dt. 01.12.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-159626/22 dt. 19.10.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Labinot Bashota; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Ilir Babaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Astrit Salihu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Abaz Kelmendi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Artan Dashi; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Valon Ajazi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Xhavit Fetahu me nr. të licensës 75;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimet e makineris, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa e përkoshme afariste/depo mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.


Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa e përkoshme, afariste/depo, mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën e përkoshme, afariste/depo.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-240955/22 DT. 27.09.2024**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  


Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi



